



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL
KOMISIONERI

Nr. 42/10 prot.

Tiranë, më 16.10.2024

VENDIM
Nr. 57, datë 16.10.2024

PËR
PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË VERIFIKIMIT TË EKZEKUTIMIT TË
VENDIMIT TË KOMISIONERIT NR. 19, DATË 15.02.2024

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe Rregulloren, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, ndryshuar me vendimin nr. 158, datë 30.12.2022, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorit të Përgjithshëm të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes dhe Drejtorit të Drejtorisë së Zbatimit të Vendimeve Paralajmëruese, në lidhje me verifikimin e zbatimit të Vendimit nr. 19, datë 15.02.2024, të Komisionerit, “Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në institucionin e Bashkisë Patos dhe paralajmërimin e institucionit për rregullimin e ligjshmërisë, me qëllim përmirësimin e situatës”,

KONSTATOVA SE:

Me Vendimin nr. 87, datë 31.10.2023, “Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjshmërisë gjatë zhvillimit të procedurave të plotësimit të pozicioneve të lira në shërbimin civil nëpërmjet pranimit në shërbimin civil; lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë, në Bashkinë Patos”, Komisioneri ka filluar mbikëqyrjen në lidhje me zbatimin e ligjshmërisë gjatë zhvillimit të procedurave të plotësimit të pozicioneve të lira në shërbimin civil, nëpërmjet pranimit në shërbimin civil; lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë, duke vlerësuar respektimin e kërkesave të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, nga ana e subjekteve të ngarkuara prej ligjit me detyra specifike për administrimin e këtij procesi në institucionin Bashkia Patos.

Ky proces është përmbyllur me Vendimin nr. 19, datë 15.02.2024, “Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në institucionin e Bashkisë Patos dhe paralajmërimin e institucionit për rregullimin e ligjshmërisë, me

prot., datë 10.04.2024, të njësisë përgjegjëse, si në procedurën e lëvizjes paralele, ashtu edhe në atë të ngritjes në detyrë, nuk është paraqitur asnjë kandidat.

Sa më sipër, çmoj se nga ana e institucionit janë kryer veprimet administrative të nevojshme për zbatimin e detyrës së lënë, por ndodhur në kushtet e pamundësisë së objektit apo qëllimit, parashikuar në nenin 95 të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, ndjekja e zbatimit të kësaj pike nuk mund të vijojë më tej.

Në pikën 3, të vendimit paralajmërues, Komisioneri ka kërkuar nga njësia përgjegjëse rishikimin e përshkrimeve të punës dhe të saktësojë kriteret e posaçme në përmbajtjen e përshkrimit të punës, lidhur me përvojën në punë, ashtu si e parashikon ligji, me qëllim që të mos ketë subjektivitet në zbatimin e këtij kriteri sipas preferencave.

Nga aktet e administruara në dosje vërej se, me e-mailin e datës 12.09.2024, të Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, Bashkia Patos, pranë Komisionerit, është përcjellë informacioni se aktualisht, institucioni i Bashkisë Patos i është nënshtruar procesit të ristrukturimit, bazuar në VKM-në nr. 503, datë 01.08.2024 “Për disa ndryshime në VKM-në nr. 328, datë 31.05.2024, për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore”.

Sa më sipër, në kushtet kur institucioni është duke u ristrukturuar, dhe ky proces kërkon kohë, referuar pikës 4, të nenit 36, të Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit, (e ndryshuar), vlerësoj se kjo pikë e vendimit duhet të jetë objekt i kontrollit gjatë mbikëqyrjes së radhës në subjekt ose mbikëqyrjes së orientuar që ushtrohet në vijimësi gjatë gjithë vitit, ku informacioni mbi ecurinë e procesit dhe realizimin e detyrës nga ana e Bashkisë Patos t’i përcillet inspektorit që e mbikëqyr këtë subjekt.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; ligjin nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” dhe Rregulloren, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, ndryshuar me vendimin nr. 158, datë 30.12.2022, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Përfundimin e procesit të verifikimit të zbatimit të Vendimit nr. 19, datë 15.02.2024, të Komisionerit, “Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në institucionin e Bashkisë Patos dhe paralajmërimin e institucionit për rregullimin e ligjshmërisë, me qëllim përmirësimin e situatës”.

2. Konstatimin e pamundësisë në objekt apo qëllim për ndjekjen e zbatimit të pikës 2 të Vendimit nr. 19, datë 15.02.2024, të Komisionerit, pasi në zbatim të detyrës së lënë, pozicioni “Përgjegjës i Shërbimeve Publike” është rishpallur dhe në procedurën e konkurrimit nuk është paraqitur asnjë kandidat.
3. Njësia përgjegjëse e Bashkisë Patos, në përfundim të procesit të ristrukturimit, të njoftojë Komisionerin për realizimin e detyrës së lënë në pikën 3 të vendimit 19/2024, që ka lidhje me rishikimin e përshkrimeve të punës, duke dërguar elektronikisht disa përshkrime pune për kategori të ndryshme të shërbimit civil, pranë inspektorit përkatës, që monitoron në vijimësi gjatë gjithë vitit zbatimin e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil në Bashkinë Patos.
4. Për këtë vendim të njoftohet Bashkia Patos.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha